

UDHËZIM
Nr. 9, datë 12.3.2026
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26,
DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e përgjithshëm të ministrit të Financave, nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Pas pikës 8.8, shtohet pika 8.9, me përmbajtjen si më poshtë:

“8.9. Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 8 të ligjit, artistët që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse plotësojnë ndonjë nga kushtet e përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, nuk konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë 24-mujore.

Kjo periudhë fillon nga data e hyrjes së tyre të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë artistike dhe zbatohet pavarësisht numrit të ditëve të qëndrimit gjatë saj. Afati 24-mujor vijon të llogaritet edhe në rast ndërprerjesh të përkohshme të qëndrimit brenda territorit dhe nuk rifillon në rast daljeje dhe rihyrjeje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pas përfundimit të periudhës 24-mujore, statusi i rezidencës tatimore të individit përcaktohet në përputhje me kriteret e tjera të parashikuara në nenin 8 të ligjit.

Me kërkesë të administratës tatimore, artisti ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin që provon hyrjen për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe periudhën e tij të qëndrimit në Shqipëri.

Shembulli 1

Këngëtari i njohur me initiale “A.A.”, shtetas italian, hyn për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 1 mars 2026 për të zhvilluar një veprimtari artistike. Gjatë 24 muajve, nga momenti i hyrjes për herë të parë, ai qëndroi në Shqipëri për më shumë se 183 ditë në secilin vit kalendarik.

Në zbatim të pikës 8.9 të këtij udhëzimi, këngëtari “A.A.” nuk do të konsiderohet rezident tatimor në Republikën e Shqipërisë për një periudhë 24-mujore, e cila fillon më 1 mars 2026 dhe përfundon më 29 shkurt 2028. Gjatë kësaj periudhe, ai trajtohet si tatimpagues jorezident dhe tatohet vetëm për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave të nenit 58, pika 2, të ligjit. Në përfundim të periudhës 24-mujore, duke filluar nga data 1 mars 2028, përcaktimi i rezidencës tatimore të tij bëhet sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në ligj.”.

2. Në pikën 11, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Në fjalinë e parë, shkronja “f” zëvendësohet me shkronjën “g”.

b) Pas pikës 11.9, shtohet pika 11.10 me përmbajtje:

“11.10 Të ardhurat që përfiton një person fizik nga sponsorizimet përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale vetëm deri në masën e kufizimeve të përcaktuara në nenin 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit.

Përfundimi zbatohet vetëm për pjesën e sponsorizimit, që plotëson kushtet dhe kufizimet ligjore për njohjen si shpenzim i zbritshëm të sponsorizimit nga sponsorizuesi. Çdo shumë që tejkalon kufirin e lejuar, sipas dispozitës së sipërcituar, konsiderohet e ardhur e tatueshme dhe i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas dispozitave ligjore.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, personi fizik përfitues duhet të disponojë dhe, me kërkesë të administratës tatimore, të paraqesë dokumentacionin, si më poshtë:

a) kontratën e sponsorizimit të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe personit fizik përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sponsorizimet;

b) dokumentin bankar që provon kryerjen e pagesës së sponsorizimit ose fatura e shitjes së mallit në vlerën e kostos;

c) vërtetim nga sponsorizuesi për shumën e sponsorizimit të njohur si shpenzim i zbritshëm, sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja "p" të ligjit. Ky vërtetim i dorëzohet përfituesit për qëllime të kryerjes së deklaratimit dhe duhet të përcaktojë:

i. shumën e sponsorizimit që njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me shumën që do t'i njihet përfituesit si e ardhur e përjashtuar; si dhe

ii. në rast se sponsorizimi tejkalon kufizimet ligjore, shumën që nuk njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me pjesën e sponsorizimit që i njihet përfituesit si e ardhur e tatueshme.

d) çdo dokument tjetër mbështetës që mund të ketë, që provon natyrën dhe përputhshmërinë ligjore të sponsorizimit.

Në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe të vlefshëm, ose kur konstatohet se nuk plotësohen kufizimet ligjore për njohjen e sponsorizimit, si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e gjithë shuma ose pjesa përkatëse konsiderohet e ardhur e tatueshme për përfituesin.

Shembull Shoqëria "A.B." sh.p.k., gjatë vitit tatimor 2026, ka kryer 2 sponsorizime kundrejt 2 përfituesve, konkretisht: - 1,000,000 lekë ka sponsorizuar sportistin e nivelit të lartë për merita në sport, me iniciale "C.D.", dhe e gjithë shuma i është dhënë në maj 2026; - 200,000 lekë ka sponsorizuar një ekip sportiv dhe e gjithë shuma i është dhënë në tetor 2026. Fitimi i tatueshëm para zbritjes së sponsorizimeve është në shumën 15,000,000 lekë. Sipas nenit 50, pika 1, shkronja "p" të ligjit, sponsorizimet për veprimtaritë sportive njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën 5% të fitimit të tatueshëm. Ndërkohë që, të ardhurat që përfiton një person fizik nga sponsorizimet përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale vetëm deri në masën e këtij kufizimi.	
1. Sponsorizuesi përcakton kufirin maksimal të zbritshëm për sponsorizuesin	5% e 15,000,000 lekëve = 750,000 lekë. Pra, shuma maksimale që shoqëria "A.B." sh.p.k. mund të njohë si shpenzim të zbritshëm për sponsorizime është 750,000 lekë.
2. Përcaktimi i shumës totale të sponsorizimit	Gjatë vitit 2026, shoqëria "A.B." sh.p.k. ka sponsorizuar veprimtari sportive në shumën 1,200,000 lekë (1,000,000 lekë + 200,000 lekë).
3. Përcaktimi i pjesës së njohur dhe të panjohur si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin	Nga shuma totale prej 1,200,000 lekësh: a) 750,000 lekë njihen si shpenzim i zbritshëm (brenda kufirit 5%); b) 450,000 lekë tej kalojnë kufirin ligjor dhe nuk njihen si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin.
4. Çfarë duhet të përcaktohet në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin sportist me iniciale "C.D."?	Në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin me iniciale "C.D." përcaktohet: a) Shuma totale e sponsorimit ndaj përfituesit në vlerën 1,000,000 lekë; si dhe b) Shuma e këtij sponsorizimi që do të njihet si e ardhur e përjashtuar dhe cila do të tatohet plotësisht:

	i. 625,000 lekë përcaktohen të ardhurat e përjashtuara nga tatimi për përfituesin [(750,000 lekë / 1,200,000 lekë) * 1,000,000 lekë]; si dhe ii. 375,000 lekë përcaktohen të ardhura e tatueshme për përfituesin (1,000,000 lekë – 625,000 lekë).
5. Çfarë ndodh nëse sportisti me initiale “C.D.” (përfituesi) ka mungesë dokumentacioni?	Nëse sportisti nuk disponon dokumentacionin e kërkuar, përfshirë vërtetimin mbi shumën e njohur si shpenzim i zbritshëm nga sponsorizuesi, e gjithë shuma prej 1,000,000 lekësh konsiderohet e ardhur e tatueshme.
6. Çfarë ndodh me ekipin sportiv?	Në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin ekip sportiv (sipas pikës 40.1.1 të këtij udhëzimi) përcaktohet: a) Shuma totale e sponsorimit ndaj përfituesit në vlerën 200,000 lekë; si dhe b) Shuma e këtij sponsorizimi do të njëhet si e ardhur e përjashtuar dhe cila do të tatohet plotësisht: i. 125,000 lekë përcaktohen të ardhurat e përjashtuara nga tatimi për ekipin sportiv [(750,000 lekë / 1,200,000 lekë) * 200,000 lekë]; si dhe ii. 75,000 lekë përcaktohen të ardhura e tatueshme për ekipin sportiv (200,000 lekë – 125,000 lekë).

3. Pas pikës 12.8, shtohet pika 12.8.1 me përmbajtjen, si më poshtë:

“12.8.1 Rregulli i mësipërm nuk zbatohet në rastin kur individ i vetëpunësuar, pavarësisht se të ardhurat e tij plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjën “ç”, nënparagrafët “i” dhe/ose “ii” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit, vetëdeklararon se nuk ndodhet në kushtet e të ardhurave nga punësimi.

Vetëdeklarimi kryhet nëpërmjet “Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit”, sipas modelit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur ligjit, e cila dorëzohet pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar tatimpaguesi, dhe shoqëron Deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që dorëzohet brenda muajit mars të vitit pasardhës, përfshirë edhe deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që do të dorëzohet brenda datës 31 mars 2026.

Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore, për të përcaktuar nëse individ i vetëpunësuar nuk ndodhet në kushtet e shmangies tatimore.

Në rast se gjatë verifikimeve apo kontroleve, administrata tatimore pas analizimit të sjelljes së të vetëpunësuarit; kontrollit mbi faktorët dhe produktin e shërbimit si dhe natyrës së marrëdhënies, konstaton se një tatimpagues i vetëpunësuar, i cili mund të ketë dorëzuar ose jo “Deklaratën e statusit të vetëpunësuarit”, ofron shërbime të cilat rezultojnë në situatë shmangie tatimore, të ardhurat e tatimpaguesit të vetëpunësuar të vetëdeklaruar si të ardhura nga biznesi do të konsiderohen si të ardhura nga punësimi.

Administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të të ardhurave në rast se deklarimi është i pasaktë. Rivlerësimi në këto raste bëhet sipas parashikimeve të dispozitave rregulluese për procedurat tatimore.

Shembulli 1

Një individ i vetëpunësuar, i regjistruar me aktivitet “Shërbime për shfaqje artistike”, gjatë vitit tatimor 2025 realizon të ardhura bruto në shumën 3,500,000 lekë. Nga këto të ardhura, 2,900,000 lekë, ose rreth 83% e totalit, realizohen nga një klient i vetëm rezident tatimor në Republikën e Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave realizohet nga dy klientë të tjerë të ndryshëm.

Referuar shkronjës “ç”, pika 1, e nenit 12 të ligjit, ky individ do të plotësojë kriterin për t’u trajtuar si e ardhur nga punësimi për qëllime tatimore. Megjithatë, individ i vetëpunësuar, duke vlerësuar rrethanat konkrete të marrëdhënies ekonomike me klientin, dorëzon pranë drejtorisë tatimore rajonale Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit, në të cilën vetëdeklararon se nuk ndodhet në kushtet e të ardhurave nga punësimi.

Deklarata dorëzohet brenda muajit mars, së bashku me Deklaratën Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi. Në këtë rast, deri në një vlerësim të kundërt nga administrata tatimore, të ardhurat e individit të vetëpunësuar

trajtohen si të ardhura nga biznesi, dhe individit plotëson rubrikat përkatëse të të ardhurave nga biznesi në Deklaratën Tatimore Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi.

Administrata tatimore, në ushtrim të kompetencave të saj në zbatim të ligjit për procedurat tatimore, përdor Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit si mjet vlerësimi për verifikimin e mëtejshëm për të përcaktuar nëse ky tatimpagues është apo jo në kushtet e shmangies tatimore.

Shembulli 2

Një doktor me initiale “A.N.” është i vetëpunësuar, ka një kontratë shërbimi me një spital dhe përfiton të ardhura vjetore prej 200.000 lekësh, sipas faturimit që kryen kundrejt spitalit. Gjatë ushtrimit të detyrës ai përdor pajisjet e spitalit (aparatura, sallat, zyrrat, materialet mjekësore) pa investuar vetë. Pacientët që mjekon i siguron spitali, nuk i sjell ai vetë. Ai e ushtron detyrën në orarin e përcaktuar nga spitali. Spitali mbikëqyr punën e tij dhe vendos rregullat që ai duhet të ndjekë gjatë ushtrimit të detyrës sipas rregulloreve të spitalit.

Pra, pavarësisht se doktori “A.N.” sillet si një vetëpunësuar, në fakt sjellja e tij është e njëjtë me atë të një të punësuar pasi ai është i varur nga spitali për punën dhe mjetet, ai nuk mbart risk financiar, prandaj për qëllime tatimore ai do të trajtohet si punonjës i spitalit.

Shembulli 3

Një kuzhinier me initiale “B.C.” ushtron profesionin si i vetëpunësuar në restorantin “Z” dhe nuk mund ta delegojë apo zëvendësojë me dikë tjetër veten e tij. Restoranti ku ai punon, ka investuar mbi të gjitha pajisjet e kuzhinës dhe furnizon të gjitha materialet që i duhen kuzhinierit “B.C.” për të kryer punën e tij. Gjithashtu, restoranti ka përcaktuar dhe orarin dhe ditët e punës të kuzhinierit “B.C.” Ai paguhet me pagë fikse mujore 250,000 lekë pavarësisht qarkullimit që kryhet në restorant, sipas kontratës që ka me restorantin.

Pra, kuzhinieri “B.C.” në këtë rast është një punonjës i restorantit, pavarësisht sjelljes së tij si i vetëpunësuar, për arsye se sjellja e tij është e njëjtë me atë të një punonjësi, ai nuk mbart risk dhe puna e tij kontrollohet tërësisht nga restoranti.

Shembulli 4

Personi i vetëpunësuar me initiale “E.D.” është një shkrimtar. Ai përdor mjetet e veta (kompjuter, printer etj.) për shkrimet e tij. Punën ai e kryen në ambientet e shtëpisë së tij dhe orarin e punës e ka të papërcaktuar. Shkrimet e tij mund të jenë në formë të ndryshme (si libër apo artikuj të ndryshëm). Për çdo shkrim të tij, ai merr pagesën përkatëse, sipas marrëveshjes që bën me shtëpinë botuese apo redaksinë që ai zgjedh vetë.

Ky shkrimtar në këtë rast është kontraktor i pavarur, për arsye se e gjithë puna bazohet në krijimtarinë e tij të pavarur dhe nuk kontrollohet apo drejtohet nga një shtëpi botuese apo redaksi, dhe në këtë mënyrë është ai që mbart dhe riskun e të ardhurave të tij.

Shembulli 5

Arditi, një hidraulik me përvojë, ka rënë dakord me një kompani për të kryer shërbime me kohë të plotë në kantieret e ndërtimit si i vetëpunësuar. Ai përdor mjetet e tij personale dhe kryen punën sipas rendit dhe specifikimeve të përcaktuara nga kompania. Kompania furnizon të gjitha materialet, kryen inspektime të shpeshta të punës së tij, e paguan atë sipas sasisë së punës së kryer. Arditi nuk ka një vendndodhje biznesi dhe nuk kërkon të ofrojë shërbime të ngjashme për palë të tjera. Të dyja palët mund ta ndërpresin marrëdhënien në çdo kohë.

Arditi në këtë rast është qartësisht një punonjës i kompanisë, pasi e gjithë puna e tij drejtohet nga kompania, ai nuk mbart risk financiar. Pavarësisht se ai përdor mjetet e tij personale në kryerjen e punës dhe faturon kompaninë për çdo shërbim të tij, është kompania ajo që i siguron atij punën, kontrollon cilësinë e saj, furnizon Arditi me të gjitha materialet e nevojshme dhe është e vetmja kompani me të cilën Arditi operon.”.

4. Në pikën 20.1, pas togfjalëshit “agjenti i mbajtjes së tatimit në burim” shtohet togfjalëshi “, pavarësisht nëse derdhja e kontributit bëhet nga punëdhënësi, nga punëmarrësi apo nga çdo kontribues tjetër për llogari të punëmarrësit”.

5. Në pikën 30, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në pikën 30.2, togfjalëshi “*duke i shtuar të ardhurave që i nënshtrohen tatimit*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*duke i shtuar fitimit para tatimit*”.

b) Në pikën 30.4, togfjalëshi “*EBITDA = fitimi i tatueshëm*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*EBITDA = fitimi*”.

6. Pas pikës 40.1, shtohet pika 40.1.1 me përmbajtjen, si më poshtë:

“40.1.1 Nuk do të konsiderohen të ardhura të tatueshme të ardhurat që përfiton një entitet nga sponsorizimet deri në masën e kufizimeve të përcaktuara në nenin 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit.

Përjashtimi zbatohet vetëm për pjesën e sponsorizimit që plotëson kushtet dhe kufizimet ligjore për njohjen si shpenzim i zbritshëm të sponsorizimit nga sponsorizuesi. Çdo shumë që tejkalon kufirin e lejuar sipas dispozitës së sipërcituar konsiderohet e ardhur e tatueshme dhe i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat e korporatave, sipas dispozitave ligjore.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, entiteti përfitues duhet të disponojë dhe, me kërkesë të administratës tatimore, të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) kontratën e sponsorizimit të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe entitetit përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sponsorizimet;

b) dokumentin bankar që provon kryerjen e pagesës së sponsorizimit ose fatura e shitjes së mallit në vlerën e kostos;

c) vërtetim nga sponsorizuesi mbi shumën e sponsorizimit të njohur si shpenzim i zbritshëm, sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit. Ky vërtetim i dorëzohet përfituesit për qëllime të kryerjes së deklaramit dhe duhet të përcaktojë:

i. shumën e sponsorizimit që njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me shumën që do t'i njihet përfituesit si e ardhur e përjashtuar; si dhe

ii. në rast se sponsorizimi tejkalon kufizimet ligjore, shumën që nuk njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me pjesën e sponsorizimit që i njihet përfituesit si e ardhur e tatueshme.

d) çdo dokument tjetër mbështetës që mund të ketë, që provon natyrën dhe përputhshmërinë ligjore të sponsorizimit.

Në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe të vlefshëm, ose kur konstatohet se nuk plotësohen kufizimet ligjore për njohjen e sponsorizimit si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e gjithë shumta ose pjesa përkatëse konsiderohet e ardhur e tatueshme.”.

7. Në pikën 50.1, shkronja “v” bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë:

a) Në nënparagrafin “ii”, togfjalëshi “*si dhe ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare*” zëvendësohet me togfjalëshin “*organizatave sportive, komitetete olimpike, ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, si dhe sportistët e nivelit të lartë që kanë fituar tituj për meritë në sport,*”;

b) Nënparagrafi “iii” ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“iii. deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimin e aktiviteteve për kërkim dhe zhvillim, të cilat ndërmerren me qëllim përfitimin e njohurive të reja për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë dhe aplikimin e tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose shërbime.”;

c) Pas nënparagrafit “iii” shtohet nënparagrafi “iv” me përmbajtje, si më poshtë:

“iv. deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfaqësojnë në nënparagrafët “i”, “ii” dhe “iii” më sipër.”;

d) Në paragrafin e parë, pas nënparagrafit “iv”, pas togfjalëshit me përmbajtje: “*Për tatimpaguesit, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të*

federatare sportive,” shtohet togfjalëshi me përmbajtje: “organizatare sportive, komiteteve olimpike, ekipeve kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, si dhe sportistëve të nivelit të lartë që kanë fituar tituj për meritë në sport.”.

8. Pas pikës 66.1, shtohet pika 66.1.1 me përmbajtje si më poshtë:

“66.1.1 Në rastet kur punëmarrësi ka më shumë se një punësim dhe njëri prej tyre është në administratë shtetërore, për qëllime të aplikimit të zbritjeve mujore përmes sistemit të centralizuar të pagesave, deklarata e statusit personal paraqitet pranë punëdhënësit në administratën shtetërore.”.

9. Në aneksin nr. 2 të projektudhëzimit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në formularin “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, në rubrikën nr. 26 me titull: “*Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit*”, bëhet riformulim i titullit me përmbajtje “*Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi/punëmarrësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit*”.

b) Në “Udhëzuesi i plotësimit të listëpagesës...”, pika 26 e udhëzuesit, riformulohet, si më poshtë:

“26. Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi/punëmarrësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit – zbritet nga të ardhurat personale të të punësuarit për efekt tatimi. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit. Shuma që zbritet nga paga si kontribut për punëmarrësin në fondet e pensionit vullnetar nuk duhet të jetë më e madhe se paga minimale në shkallë vendi. Për zbritjet e bëra, punëdhënësi duhet të disponojë dokumentacion justifikues, si:

a) Kontratën e lidhur me fondin e pensionit vullnetar;

b) Vërtetimin/dokument të lëshuar nga fondi i pensionit vullnetar, i cili vërteton që këto zbritje janë derdhur si pagesë në këtë fond. Vërtetimi dorëzohet një herë në vit për të gjithë vitin tatimor në të cilin derdhen kontributet në fondin e pensionit, brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.

Ky dokumentacion duhet të administrohet në çdo kohë dhe të vihet në dispozicion të administratës tatimore nëse kërkohet.”.

10. Në pikën 61.6, pas togfjalëshit “si dhe në sistemin e-Tax”, shtohet togfjalëshi: “sipas afateve të dorëzimit të deklaratës përkatëse.

11. Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “mjete virtuale” zëvendësohet me togfjalëshin “kripto-aset”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

Botuar ne F.Zyrtare 57/2026

Dale nga shtypi me 18.03.2026